



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1464 Prot.

Tiranë, më 05.10 2023

VENDIM

Nr. 106 datë 05.10 2023

PËR  
MIRATIMIN E PROCEDURAVE DHE TARIFAVE TË KONFIRMIMEVE  
TË DOKUMENTACIONIT TË LËSHUAR  
NGA UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

Mbështetur në nenin 3 dhe 38 të Ligjit nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, si dhe në Vendimin e Rektoratit nr. 94 datë 28/09/2023 “Për propozimin e procedurave dhe tarifave të konfirmimeve të dokumentacionit të lëshuar nga Universiteti i Sporteve të Tiranës”, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 05.10.2023,

VENDOSI:

1. Procedurat e konfirmimeve në Universitetin e Sporteve të Tiranës propozohen të realizohen sipas:
  - **Procedurës së thjeshtë** – kryhet në rastin kur personat e interesuar kërkojnë konfirmimin e dokumenteve shkollore të lëshuar më parë nga Universiteti i Sporteve të Tiranës – me vërtetim autenticiteti nga Rektori i UST.
  - **Procedurës zyrtare** – kryhet në rastin kur personat e interesuar, kërkojnë që dokumentet e tyre shkollore të verifikohen dhe të dërgohen në mënyrë zyrtare nga Universiteti i Sporteve të Tiranës në adresë / email / sistem të institucioneve të huaja sipas kërkesës së aplikantit.
2. Për procedurën e thjeshtë pagesa aktuale prej 400 (katërqind) lek propozohet të ndryshojë dhe të bëhet 1000 (njëmijë) lek.
3. Për procedurën zyrtare, si një procedurë e re e paaplikuar më parë, propozohet që pagesa të jetë 5000 lek, e cila përfshin procedurën e brendshme administrative si dhe atë të dërgimit postar.
4. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në website zyrtar të institucionit.
5. Ky Vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST-së.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA

